



Republika e Kosovës • Republika Kòsovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 19 shkurt 2020

Z. Agim Veliu, Ministër
Ministria e Punëve të Brendshme
Rruga "Luan Haradinaj" p.n.
10000 Prishtinë

LETËR REKOMANDIMI

A.nr.683/2019

Agron Hasanaj
kundër

Inspektoratit Policor të Kosovës

I nderuari z. Veliu,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, e ka pranuar ankesën e z. Agron Hasanajt, parashtruar kundër Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK), përkitazi me pretendimet për cenimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, me instrumente ndërkombëtare si dhe me Kodin nr.04/L-123 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK).

Sipas shkresave të lëndës dhe informacioneve që i kemi, më 26 qershor 2019, hetuesit e IPK-së e kanë intervistuar z. Hasanajt, në cilësinë e të dyshuarit, përkitazi me pretendimet për kryerjen e veprës penale "Mashttrim", e cila ndërlidhet me beneficionin financiar të "Invalidit të Luftës së UÇK-së". Tutje z. Hasanaj, me rastin e përfundimit të deklaratës në IPK, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, ka kërkuar kopjen e deklaratës së tij dhe nga inspektori i IPK-së ka marrë përgjigje refuzuese, me arsyetimin se i njëjti e kishte kontaktuar përmes telefonit prokuroren e rastit dhe ajo i kishte kërkuar që në këtë fazë të mos i dorëzohet kopja e deklaratës. Për më shumë, z. Hasanaj pretendon se hetuesi i IPK-së, në faqen e fundit të deklaratës së tij, e ka bërë një shënim me laps, në të cilin ka shkruar: "*Kjo kopje mund të merret vetëm në prokurori.*"

Më 1 korrik 2019, z. Hasanaj, përmes postës elektronike, ka parashtruar ankesë në IPK, me ç'rast i ka njoftuar ata me pretendimet për shkelje ligjore nga hetuesi i IPK-së në rastin e tij, dhe sërish e ka kërkuar kopjen e deklaratës së tij.

Më 17 korrik 2019, IPK-ja e ka nxjerrë *Njoftimin nr. 03/116/1055/1*, përmes të cilit e ka njoftuar z. Hasanajn se IPK-ja e kishte pranuar dhe trajtuar ankesën e tij kundër hetuesit të

IPK-së. Në këtë drejtim, IPK-ja ka sqaruar se Divizioni i Burimeve Njerëzore i IPK-së e kishte analizuar ankesën me të gjitha faktet dhe dëshmitë lidhur me rastin dhe kishte gjetur se hetuesi i IPK-së kishte vepruar sipas udhëzimeve të prokurorit kompetent, prandaj kishte konstatuar se nuk ekzistojnë elemente të shkeljes disiplinore me pretendimet e ngritura nga z. Hasanaj përmes ankesës.

Më 26 korrik 2019, z. Hasanaj ka parashtruar kërkesë në Departamentin Ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), ku ka kërkuar Opinion Ligjor përkitazi me çështjen:

1. *A është dashur të shërbehet me kopje të deklaratës së tij pas intervistimit në IPK?*
2. *A është kjo e drejtë e tij ligjore?*
3. *A përbën shkelje ligjore veprimi i hetuesit të IPK-së?*
4. *A është standard i IPK-së që fjala e prokurorit të jetë mbizotëruese mbi normat ligjore?*

Më 13 gusht 2019, Departamenti Ligjor i MPB-së e ka nxjerrë *Opinionin Ligjor nr.165*, përmes të cilit e ka bërë citimin dhe shpjegimin e ligjit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 172, paragrafi 4, të KPPRK-së, si dhe në nenin 17, paragrafi 1, të Ligjit nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës. Për më tepër, Opinioni Ligjor e ka analizuar zbatimin e ligjit duke u bazuar në faktet dhe në rrethanat e rastit dhe, përveç tjerash, ka nxjerrë përfundimin:

1. *Çdo njeri në çdo procedurë pranë organeve kompetente duhet të trajtohet pa asnjë lloj dallimi;*
2. *Pas nënshkrimit të procesverbalit policor nga ana e palës, i njëjti duhet të jetë në dispozicion për palën nëse ai/ajo e kërkon.*
3. *Hetuesit e IPK-së ushtrojnë autorizimet e tyre të pavarur, duke mos u ndikuar nga askush, në përputhje me Kushtetutën, KPPRK-në dhe legjislacionin në fuqi.*

Më 25 shtator 2019, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka zhvilluar takim të përbashkët me udhëheqësin e Departamentit të Inspektimit (*i cili gjatë kësaj kohe ishte duke e zëvendësuar kryeshefen e IPK-së*) dhe me udhëheqësin e Departamentit të Hetimeve të IPK-së, me të cilët e ka diskutuar çështjen e z. Hasanajt. Ata e kanë njoftuar për zhvillimet e ngjarjes, por nuk ishin të njoftuar përkitazi me Opinioni Ligjor të lëshuar nga Departamenti Ligjor i MPB-së. Meqenëse hetuesi i rastit nuk gjendej në punë, zyrtarët e IPK-së kanë premtuar se i njëjti do të njoftohet lidhur me çështjen sapo të kthehet në punë dhe, meqenëse u sqarua se nuk ka pengesa ligjore, ata u zotuan se z. Hasanajt dhe IAP-së do t'u dërgohet nga një kopje e deklaratës.

Më 3 tetor 2019, IAP-ja është njoftuar se brenda strukturave udhëheqëse të IPK-së sërish ishte diskutuar çështja e deklaratës së z. Hasanajt dhe ishte marrë qëndrim që z. Hasanajt të mos i dërgohej kopja e deklaratës nga IPK-ja, duke shtuar se i njëjti mund ta kërkonte kopjen e deklaratës së tij në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Më 5 nëntor 2019, Avokati i Popullit i ka dërguar shkresë Kryeshefes ekzekutive të IPK-së, për të kërkuar informata lidhur me ankesën e z. Hasanajt, si dhe për veprimet që ishin ndërmarrë nga IPK-ja, në kuptim të zbatimit praktik të nenit 23 dhe të nenit 24, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 172, paragrafi 4, të KPPRK-së, të nenit 5,

paragrafët 2 dhe 5, dhe të neni 17, paragrafi 1, të Ligjit nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Më 20 nëntor 2019, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga IPK-ja, ku ndër tjerash thuhej: *“Sa i përket çështjes së deklaratës së z. Agron Hasanaj, i cili në rastin të cilin është duke hetuar IPK-ja me autorizim të Prokurorisë, ju informojmë se IPK-ja nuk ka marrë qëndrim që z. Hasanajt të mos i dërgohet kopja e deklaratës, por IPK-ja në këtë rast ka vepruar sipas sygjërimeve të Prokurores së çështjes e cila është konsultuar pas kërkesës së z. Hasanajt për marrje të kopjes së deklaratës, e njëjta ka sygjëruar hetuesin, se nëse nuk është praktikuar që edhe në rastet tjera të dyshimëve t’iu dorëzohet kopja e deklaratës edhe në rastin konkret të mos i dorëzohet kopja e deklaratës por vetëm të konstatohet se personi i dyshimtë nuk donë me nënshkruar deklaratën. Lidhur me këtë është informuar edhe z. Hasanaj nga vetë hetuesi i IPK-së. Për shkak, se IPK-ja çështjen në fjalë është duk e hetuar në bazë të Autorizimit të prokurorisë dhe çdo veprim hetimor e bënë në bazë të këtij autorizimi dhe sygjërimeve të prokurorisë, andaj do ta kontaktojmë prapë prokurorin lidhur me dërgimin e kopjes së deklaratës z. Hasanaj.”*

Neni 21, paragrafët 2 dhe 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Kushtetuta) përcaktojnë si në vijim: *“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë, Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”*

Neni 22 i Kushtetutës përcakton: *“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.”* Neni 23 përcakton: *“Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”,* ndërsa paragrafi 1, i nenit 24 përcakton: *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.”*

Më tutje, neni 53 rregullon interpretimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut, të garantuara me këtë Kushtetutë, duke theksuar: *“Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*

Paragrafi 2 i nenit 172 të Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës përcakton: *“Policia mban procesverbal për çdo seancë të marrjes në pyetje të personit të arrestuar, duke përfshirë kohën e fillimit dhe të përfundimit të marrjes në pyetje, identitetin e zyrtarit të policisë i cili e ka marrë në pyetje dhe personat tjerë të pranishëm. Kur mbrojtësi nuk ka qenë i pranishëm, kjo shënohet në mënyrë të rregullt në procesverbal.”* Ndërsa paragrafi 4 i po këtij neni përcakton: *“Procesverbalet nga paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni i vihen në dispozicion personit të arrestuar dhe mbrojtësit të tij me kërkesën e tyre, në gjuhë të kuptueshme për të arrestuarin.”*

Neni 3 i Ligjit nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës përcakton: *“Misioni i Inspektoratit Policor të Kosovës është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së tij, të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara.”* Ndërsa neni 5 i po këtij Ligji përmban parimet kryesore, me ç’ rast do t’i përmendim disa prej tyre, e të cilat përcaktojnë si në vijim:

- Paragrafi 2 përcakton: “*Punonjësit e IPK-së, në përmbushje të detyrave të tyre, do të respektojnë ligjin në fuqi, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe kontribuojnë në realizimin e tyre.*”
- Paragrafi 3 përcakton: “*IPK udhëhiqet nga parimet e profesionalizmit, objektivitetit, paanshmërisë politike dhe mos diskriminimit.*”
- Paragrafi 5 përcakton: “*Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, IPK është e pavarur.*”
- Paragrafi 7 përcakton: “*IPK, duhet t'i zhvillojnë hetimet e tyre në mënyrë të saktë dhe të shpejtë, më qëllim të rritjes së besimit në sundimin e ligjit.*”
- Paragrafi 8 përcakton qartazi: “*Hetuesit e IPK-së autorizimet e tyre i ushtrojnë në pajtim me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale.*”

Më tej, neni 6 i po këtij Ligji përcakton: “*IPK është institucion ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e pavarur nga Policia e Kosovës dhe në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrisë.*” Ndërsa paragrafi 1 i nenit 17 përcakton: “*Hetuesit e IPK-së gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, kanë autorizimet policore dhe i ushtrojnë ato në përputhje me Kushtetutën, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, me këtë ligj si dhe me ligjet dhe aktet nënligjore tjera në fuqi.*”

Në kuptim të dispozitës së nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Avokati i Popullit rikujton se Konventa përcakton se gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër. Në çështjen e ankuesit vërehet se ankesa ka filluar nga zyrtari policor, i cili nuk ka kërkuar asgjë më shumë se zbatimin e të drejtave të tij ligjore, respektivisht ligjit penal të aplikueshëm. Mohimi i shfrytëzimit të kësaj të drejte bazuar në ligje të përgjithshme mund të konsiderohet shkelje e të drejtave të njeriut, respektivisht i së drejtës ligjore të të dyshuarit dhe shkelje e parimit të sigurisë juridike, si një parim i përgjithshëm i së drejtës për të drejtat e njeriut. Avokati i Popullit insiston në atë se ligji vlen për të gjithë dhe se askush nuk është i përjashtuar nga ligji dhe nuk është mbi ligjin.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (më tutje GjEDNj) ka ripërsëritur praktikën e saj tanimë të etabluar, sipas së cilës parimi i sigurisë juridike nënkupton se ligji duhet të jetë i qasshëm dhe i parashikueshëm. Këto kërkesa janë përsëritur në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së duke sqaruar: “*Parashikueshmëria nënkupton se ligji duhet të jetë i parashikueshëm në efektin e tij, sipas formulimit të tij. Formulim i cili duhet të jetë preciz që i mundëson individit të rregullojë çështjen e tij.*” (Shih Vendimin e GjEDNj-së në rastin *Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 6538/74, i datës 26 prill 1979 § 46 ff dhe Vendimin e GjEDNj-së *Rekvényi kundër Hungarisë* 25390/94, i datës 20 maj 1999 § 34 ff).

GjEDNj-ja gjithashtu thekson: “*Do të ishte në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës, nëse do t'i lihej ndonjë diskrecion ligjor ekzekutiv. Rrjedhimisht, ligji duhet të tregojë qëllimin e çdo diskrecioni të tillë dhe mënyrën e ushtrimit të tij me qartësi të mjaftueshme, për t'i dhënë mundësi individit në mbrojtje adekuate kundër arbitraritetit.*” (Shih Vendimin e GjEDNj-së në rastin *Malone kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të datës 2 gusht 1984 § 68).

Si pjesë përbërëse e parimit të sigurisë juridike garantohet edhe parimi i pritjes legjitime. “Në bazë të doktrinës së pritjes legjitime, ata të cilët veprojnë me mirëbesim dhe në përputhje me ligjin, nuk duhet të jenë të frustruar nga pritjet e tyre legjitime. Kjo doktrinë nuk gjen zbatim vetëm në procedura të ligjdhënies, por edhe në nxjerrjen e vendimeve në rastet individuale nga autoritetit publik.” (Shih Vendimin e GjEDNJ-së *Anhaeuser-Busch Inc. kundër Portugalisë*, 73049/01, i datës 11 janar 2007 § 65).

Me sigurinë juridike, mes tjerash, kërkohet që premtimet dhënë individëve nga shteti (pritjet legjitime) duhet të respektohen. Po ashtu, siguria juridike nënkupton që ligji të jetë i qartë dhe i zbatueshëm në praktikë¹.

Parimi i shtetit të së drejtës, si parim themelor i Kushtetutës dhe i Konventës, obligon organet shtetërore që ta respektojnë/zbatojnë legjislacionin e aprovuar nga legjislativi i vendit. Garancitë kushtetuese për të drejtat e njeriut janë vlera themelore të shoqërisë demokratike, që i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut, lirisë dhe barazisë, sepse këto vlera janë baza themelore për funksionimin e shtetit dhe të së drejtës, si dhe janë parakusht i respektimit të parimit të ndarjes së pushteteve. Kësisoj janë vendosur parimet e përgjithshme të përcaktimit të garancive që burojnë nga parimi i ligjshmërisë, përmes të cilit ndërtohet një sistem efikas juridik që ofron siguri juridike për qytetarët.

Nga ajo që u tha më sipër shihet qartazi se e gjithë kjo gjendje e krijuar në lidhje me rastin e z. Hasanajt kishte ardhur pasi që IPK-ja kishte përjashtuar shprehimisht vlefshmërinë e legjislacionit të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe pa mbështetje në bazë adekuate juridike të prokurorëve dhe kësisoj ishte krijuar një situatë e “*nudum ius*”, ku ligjet ekzistojnë, por nuk zbatohen.

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 18 të Ligjit për Avokatin e Popullit, i rekomandon ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme:


- ***Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet që burojnë nga ligji, të nxjerrë udhëzime të cilën do të kërkojë nga IPK-ja që, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, të veprojnë në përputhje me Kushtetutën, me Kodin Penal, me Kodin e Procedurës Penale, si dhe me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, në mënyrë që situata të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.***
- ***T’i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të IPK-së, në kuptim të zbatimit praktik të ligjit dhe të respektimit të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut.***
- ***Në kuadër të mandatit ligjor, të kërkojë nga zyrtarët përgjegjës të IPK-së që, pa vonesa të mëtutjeshme, t’ia dërgojnë z. Hasanajt kopjen e deklaratës së dhënë në IPK, më 26 qershor 2019.***

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar

¹ EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION)REPORT ON THE RULE OF LAW Adopted by the Venice Commission at its 86th plenary session (Venice, 25-26 March 2011) (44-51).

rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerri lidhur me këtë çështje.

Me nderime,


Hilmi Jashari

Avokat i Popullit